

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.25.05.2021*

25.05.2021
Ora 12:04

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Dibër, me kandidatin nga lista shumëemërore e Partisë Aleanca Demokristiane e Shqipërisë, z.Armando Agron Manjani”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Ilirjan Celibashi**

2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, A.Tenolli**

Z.I.Celibashi: Mirëdita! Atëherë, fillojmë seancën publike të Komisionerit Shtetëror për shqyrtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me projektvendimin për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Dibër, me kandidatin nga lista shumëemërore të partisë Aleanca Demokristiane e Shqipërisë.

2. Projektvendimi për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Mallakastër, me kandidatin nga lista shumëemërore të Partisë Socialdemokrate.

3. Projektvendim për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vau i Dejës, me kandidatin nga lista shumëemërore e Partisë Socialiste.

4. Projektvendim për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatin nga lista shumëemërore të Partisë Socialiste Qarku Fier.

5, Projektvendim për shpalljen e moszgjedhshmërisë për kandidatin në listën shumëemërore të Partisë Socialdemokrate për Qarkun Shkodër.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.25.05.2021*

Atëherë fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, që ka të bëjë me: Projektvendimin për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Dibër, me kandidatin nga lista shumëemërore e Partisë Aleanca Demokristiane e Shqipërisë.

Z.Y.Merkaj: Në datën 07.04.2021 Këshilli i Bashkisë Dibër ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari Spartak Koltraka, propozuar nga Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë. Referuar nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumëemërore e Partisë Aleanca Demokristiane për këshilltarin e Bashkisë Dibër, është kandidati me numër rendor 8, zoti Armando Manjani. Referuar nenit 11 të ligjit 138, të vitit 2005, për dekriminalizimin, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të dhëna në përputhje me këtë ligj bëhet për çdo kandidat të listës shumëemërore në zgjedhjet pararendëse për Këshillin e Bashkisë, të cilit i takon të marrë mandatin e mbetur vakant. Kandidati për këshilltar ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2161/1, gjithashtu nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë, e cila ka të bëjë me ndalimet e ligjit nr.138 të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e Gjendjes Civile dhe zyra e Gjendjes Gjyqësore, ku në përgjigje të kërkesës sonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer përgjigje, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve verifikimin e gjendjes gjyqësore, ku rezulton se kandidati për anëtar të Këshillit të Bashkisë Dibër, Armando Manjani rezulton i padënuar dhe pa shënime në sistemin e dënimeve penale. Referuar pikës së dytë, të kreut të psetë të vendimit nr.17 të vitit 2016, të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zotit Armando Manjani në Këshillin e Bashkisë Dibër, nuk përbëjnë kusht për

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.25.05.2021*

moszgjedhjen e tij në funksionin e këshilltarit. Në këto kushte i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve pranimin e kërkesës dhe zëvendësimin e vendit vakant.

Z.I.Celibashi: Mirë, faleminderit! Atëherë bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n” dhe 2 neni 164, pika 2 dhe 4 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë si dhe nenit 11, të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, si dhe kreut të pestë të vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr.17/2016” vendos: Zoti Armando Agron Manjani, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Dibër, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.


2. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Dibër me kandidat nga lista shumëemërore të Partisë Aleanca Demokristiane e Shqipërisë, zotin Armando Agron Manjani.

Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 ditëve, nga hyrja në fuqi e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Vendimi nr.364

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.25.05.2021*

**25.05.2021
Ora 12:07**

RENDI I DITËS

*Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Mallakastër,
me kandidatin nga lista shumëemërore e Partisë Socialdemokrate e Shqipërisë,
zn.Anisa Agim Muçaj”.*

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z.Illirjan Celibashi

2.Stafi KQZ: Y.Merkaj, M.Koja, A.Tenolli

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën e dytë!

Z.Y.Merkaj: Në datën 06.05.2021 Këshilli i Bashkisë Mallakastër ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari Ermal Hasimaj, propozuar nga Partia Socialdemokrate e Shqipërisë. Referuar nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumëemërore e kësaj partie është kandidati me numër rendor 3, zonja Anisa Muçaj. Kandidati për anëtar i Këshillit të Bashkisë ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, me numër unik 2163. Nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit konstatohet se nuk ka asnjë të dhënë, e cila ka të bëjë me parashikimet për ndalim në ligjin nr.138 të vitit 2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Gjendjes Gjyqësore dhe Drejtoria e Gjendjes Civile, ku Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka

**Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.25.05.2021*

kthyer përgjigje kërkesës sonë. Ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqsore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqsore të kandidatit për anëtar të Këshillit Bashkisë Mallakastër, e cila rezulton pa shënime në sistem. Referuar pikës së dytë, të kreut të pestë të vendimit nr.17, të vitit 2016 të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar të Këshillit të Bashkisë Mallakastër nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit. Në këto kushte i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Mallakastër. Faleminderit!

Z.I.Celibashi: Faleminderit! Atëherë bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n” dhe pika 2, si dhe nenit 164, pika 2 dhe 4 të Kodit Zgjedhor si dhe ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike si dhe kreut të pestë të vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr.17/2016” vendos: Zonja Anisa Agim Muça kandidate për anëtar në Këshillin e Bashkisë Mallakastër, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.

2. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Mallakastër me kandidatin nga lista shumëemërore të Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë, zonjën Anisa Agim Muçaj.

Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Vendimi nr.365

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.25.05.2021*

25.05.2021
Ora 12:09

RENDI I DITËS

**Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vau i Dejës,
me kandidatin nga lista shumëemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, z.Gjon
Jak Pleshaj”.**

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z.Illirjan Celibashi

2.Stafi KQZ: Y.Merkaj, M.Koja, A.Tenolli

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën e tretë!

Z.Y.Merkaj: Në datën 17 mars 2021 Këshilli i Bashkisë Vau i Dejës ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në këtë këshill nga zonja Marte Ftoni propozuar nga Partia Socialiste. Kandidati vijues i listës shumëemërore të Partisë Socialiste për Këshillin e Bashkisë Vau i Dejës është kandidati më numër rendor 23, zoti Gjon Pleshaj. Kandidati për anëtar i Këshillit Bashkiak ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, ku nuk rezulton se ka treguar të dhëna, të cilat kanë të bëjnë me parashikimet për ndalim në ligjin nr.138 të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e Gjendjes Civile dhe zyra e Gjendjes Gjyqësore. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer përgjigje ende kërkesës sonë. Ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore, ku zoti Gjon Pleshaj rezulton i dënuar, në

**Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.25.05.2021*

vitin 1986 për vepër penale, shpërdorim i detyrës, gjithashtu rezulton i rehabilituar në bazë të nenit 69 të Kodit Penal. Në këto kushte referuar pikës 2, të kreut të pestë të vendimit nr.17, të vitit 2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar, zotit Gjon Pleshaj në Këshillin e Bashkisë Vau i Dejës nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e tij në funksionin e këshilltarit. Për këto arsye i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vau i Dejës me këtë kandidaturë.

Z.I.Celibashi: Faleminderit! Atëherë bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n” dhe pika 2, si dhe nenit 64, pika 2 dhe 4 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, si dhe ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike si dhe kreut të pestë të vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr.17/2016” vendos: Zoti Gjon Jak Pleshaj kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Vau i Dejës, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.

2. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vau i Dejës me kandidatin nga lista shumëemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, zoti Gjon Jak Pleshaj. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Vendimi nr.366

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.25.05.2021*

25.05.2021
Ora 12:12

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, Qarku Fier, zj.Gentiana Xhemal Cakrani”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z.Ilirjan Celibashi

2.Stafi KQZ: Y.Merkaj, M.Koja, A.Tenolli

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës!

Z.Y.Merkaj: Në datën 04.05.2021, Kuvendi i Shqipërisë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandatit të deputetit, zotit Bashkim Fino, deputet i zonës zgjedhore Qarku Fier, propozuar nga Partia Socialiste. Partia Socialiste është regjistruar si subjekt zgjedhor, në zgjedhjet për Kuvend të datës 25.06.2017 në datën 20 mars 2017. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendim nr.555, i datës 26.07.2017 ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 qershor 2017. Në këto zgjedhje Partia Socialiste për Qarkun Fier ka fituar 10 mandate dhe referuar nenit 164 të Kodit Zgjedhor, kandidati për deputet, të cilit i kalon mandati, është kandidati me numër rendor 11, zonja Gentiana Cakrani, e cila ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, ku nga formulari i vetëdeklarimit rezulton se nuk ka

**Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.25.05.2021*

asnjë të dhënë, të cilat kanë të bëjnë me parashikimet për ndalim në ligjin nr.138 të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e Gjendjes Gjyqësore dhe zyra e Gjendjes Civile, ku Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer përgjigje, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e verifikimit të gjendjes gjyqësore, ku rezulton se është pa shënime në sistem dhe është e pastër. Referuar pikës 2, kreut të pestë të vendimit nr.17 të Kuvendit konstatohet se, të dhënat e kandidatit për deputet, të zonjës Gentiana Cakrani, në zonën zgjedhore Qarku Fier, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë. Për sa më sipër mandati i ndërprerë i deputetit, zotit Bashkim Fino, i përket kandidatit vijues në listën shumëemërore të Partisë Socialiste në zonën zgjedhore, Qarku Fier, i renditur me numër rendor 11, zonjës Gentiana Cakrani. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim.

Z.I.Celibashi: Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “i” dhe “n” dhe pika 2 si dhe nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 11 të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, si dhe kreut të pestë të vendimit nr.17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë” vendos: Dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë kandidatit të radhës në listën shumëemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë në zonën zgjedhore Qarku Fier, zonjës Gentiana Xhemal Cakrani.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Vendimi nr.367

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.25.05.2021*

25.05.2021
Ora 12:14

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shpalljen e moszgjedhshmërisë të kandidatit të radhës, në listën shumëemërore të Partisë Socialdemokrate, Qarku Shkodër, z.Gledis Esat Celiku, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z.Ilirjan Celibashi

2.Stafi KQZ: Y.Merkaj, M.Koja, A.Tenolli

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër!

Z.Y.Merkaj: Në datën 04.05.2021 Kuvendi i Shqipërisë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës së krijuar në këtë Kuvend, nga dorëheqja e deputetit, zotit Tom Doshi, i zgjedhur për zonën zgjedhore, Qarku Shkodër, propozuar nga Partia Socialdemokrate. Referuar listës shumëemërore të kësaj partie, për zgjedhjet për Kuvend të datës 26 qershor 2017, kandidati i listës shumëemërore është kandidati me numër rendor 2, zoti Gledis Çeliku. Në zbatim të pikës 3, të kreut 2, të vendimit nr.17, të vitit 2016, të Kuvendit të Shqipërisë, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i është drejtuar zotit Gledis Çeliku për depozitimin e formularëve të vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Referuar pikës 3 të kreut të dytë, të vendimit nr.17 afati i fundit i dorëzimit të formularit të vetëdeklarimit ka qenë data: 20.05.2021. Brenda këtij afati kandidati për deputet nuk ka dorëzuar formularët e vetëdeklarimit dhe në këto kushte

**Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.25.05.2021*

referuar nenit 5, pika 2 të ligjit nr.138 të vitit 2015, për të dorëzuar formularët e vetëdeklarimit, mosparaqitja e formularit përbën shkak për mosregjistrimin apo moszgjedhjen e kandidatit si deputet në Kuvendin e Shqipërisë. Në këto kushte i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve moszgjedhjen, shpalljen e moszgjedhshmërisë së kandidatit të radhës së listës shumëemërore të Partisë Socialdemokrate, Qarku Shkodër, zotit Gledis Esat Çeliku për plotësimin e vakancës, për Kuvendin e Shqipërisë. Faleminderit!

Z.I.Celibashi: Faleminderit! Pyetje, meqenëse kandidati në radhë nuk paraqiti formularin e dekriminalizimit brenda afatit, ia kemi bërë kërkesën, ia kemi dërguar? I kemi dërguar njoftimin kandidatit të radhës?

Z.Y.Merkaj: Do të vazhdojë pas marrjes së vendimit nga Komisioneri, do të vazhdojë me kandidatin e radhës me numër rendor 3, 4, e me radhë.

Z.I.Celibashi: Atëherë, bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “i” dhe “n” pika 2, dhe neni 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë si dhe ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, si dhe kreut të dytë, pika 3 dhe 5 të vendimit nr.17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë” vendos: Të shpall moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatit të radhës në listën shumëemërore të Partisë Socialdemokrate, për Qarkun Shkodër, zotin Gledis Esat Çeliku.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



***Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.25.05.2021***

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Këto ishin të gjitha pikat e rendit të ditës. Faleminderit! Seanca mbyllet! Ditë të mbarë!

Vendimi nr.368

**Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA**

